

E.S Financial Advisory shpk
Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR
Licensa Nr.260, Date 27.08.2012
Adresa: Rruga Tefta Tashko Koço, Pall 132, Ap 1, Tirane
Mob. 0696002295
e-mail: erjons@gmail.com

Tiranë, më 22.08.2024

Lënda: Informacion në lidhje me mosrealizimin e shërbimit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë viti kalendarik 2023 për Partia Levizja Shqiperia e Re

Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin nr. 68, datë 5.7.2024, i KSHZ, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjekteve zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, i ndryshuar, jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2023 për 12 (dymbëdhjetë) Parti Politike, midis të cilave ishte dhe **Partia Levizja Shqiperia e Re**.

Menjëherë pas lidhjes së kontratës **me KQZ-në**, më datë 27.07.2024, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me **Levizja Shqiperia e Re** për fillimin e procedurave të auditimit, fillimisht nëpërmjet dërgimit të shkresës për fillimin e procedurave të auditimit në adresën zyrtare me postë. Në vazhdim shkresa jonë u kthye mbrapsht nga Posta për arsye se adresa e deklaruar nga ky subjekt është e pa-njohur.

Ne u përpoqem të gjenim kontakte të Drejtuesit të këtij subjekti ose të kerkonim adrese tjeter, por pa sukses. Ne nuk mundëm të gjejmë asnjë informacion në lidhje me këtë subjekt politik. Ne keto rrethana, është e pamundur të kryesh një angazhim auditimi edhe pse u përpoqëm të gjenim raporte të mëparshme nga ekspertët paraardhës në misione të ngjashme, si numra telefoni apo e-maile, nga kërkime në internet por edhe kjo mënyrë nuk solli rezultat.

Ne besojmë se kemi bërë përpjekjet e duhura për të vendosur komunikimin zyrtar me kryetarin dhe personat e tjerë përgjegjës në Parti por kjo që e pamundur dhe për rrjedhim misioni i auditimit për **Partia Levizja Shqiperia e Re** nuk u realizua.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

E.S Financial Advisory shpk
Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR

